



Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, si dhe nenit 11 paragrafi 4 të Rregullores nr. 03/2023 për procedurat për hetimet administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 21.11.2024, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti APK-DPKI-921/24, për z. Veton Nurkollari, anëtar i Jurisë Vlerësuese në Qendrën Kinematografike të Kosovës, për shkak se nuk ka prova që e argumentojnë dyshimin për ekzistimin e konfliktit të interesit.
- II. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin z. Veton Nurkollari, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në vijim: LPKI).

Ky rast ka filluar të trajtohet pas informatës së pranuar nga jashtë - raportuesi i rastit (DPKI-921/24), me të cilën është kërkuar inicimi i procedurës për vlerësimin e konflikt të interesit për shkak se, siç pretendohet në raportimin e rastit, z. Veton Nurkollari ka qenë kryetar i jurisë vlerësuese në kuadër të Qendrës Kinematografike të Kosovës (në vijim: QKK) në lidhje me konkursin për film të metrazhit të gjatë, në të cilën kategori ka fituar projekti producent i të cilit ka qenë A. Sh., i cili është bashkëthemelues dhe bashkëveprues në disa OJQ e Fondacione me z. Veton Nurkollari.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (në vijim: Agjencia) konform mandatit dhe kompetencave ligjore që ka sipas Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, ka trajtuar dhe shqyrtuar pretendimet e raportuesit të rastit sipas dispozitave të LPKI-së.

Agjencia, me shkresën zyrtare DPKI-06-1010/24, e ka njoftuar z. Veton Nurkollari lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit. Pas kësaj, është organizuar dhe mbajtur një takim me zyrtarin në Agjenci, me ç'rast i njëjti është njoftuar me pretendimet për konflikt të interesit dhe faktet që posedon Agjencia lidhur me këtë rast.

Z. Veton Nurkollari, në takimin e mbajtur ka paraqitur qëndrimet dhe argumentet e tij për pretendimet e ngritura për konflikt të interesit. I njëjti ka pranuar se ka qenë pjesë (anëtar) e jurisë vlerësuese të QKK-së për vlerësimin e filmave sipas konkursit për film të metrazhit të gjatë, ku në mesin e aplikacioneve ka qenë edhe aplikimi i shtëpisë filmike “V. F.” me projektin “Z.”, producent i të cilit projekt ka qenë A. Sh.

Tutje z. Veton Nurkollari ka theksuar se, nuk ka konsideruar se ka konflikt të mundshëm të interesit në këtë rast, për çfarë edhe ka nënshkruar deklaratën nën betim në QKK, për faktin se nga muaji Nëntor 2023, nuk është më anëtar i këshillit drejtues të OJQ “Fondacionit Lumbardhi”, ku A. Sh. ka qenë njëri nga pesë (5) themeluesit e kësaj OJQ-je në vitin 2015, dhe i njëjti është drejtor ekzekutiv i saj. Lidhur me këtë, z. Veton Nurkollari ka dorëzuar në Agjenci si dëshmi edhe procesverbalin e mbledhjes së këshillit drejtues të OJQ-së së lartpërmendur.

Përveç kësaj, më qëllim të sqarimit të situatës gjithnjë në kontest të zbatimit të dispozitave të LPKI-së dhe konstatimit të drejtë të gjendjes faktike, Agjencia me shkresën zyrtare DPKI-1363/24, ka kërkuar nga QKK informatat dhe dokumentacionin relevant në lidhje me Konkursin për film të metrazhit të gjatë – artistik (mbi 60 minuta), Ref. Nr. QKK 01/2023. QKK duke vepruar sipas kërkesës si më lartë, ka dërguar në Agjenci përgjigjen, informatat dhe dokumentacionin e kërkuar, shkresa zyrtare DPKI-1363-1/24.

Agjencia ka kërkuar nga përfaqësuesja e autorizuar e OJQ “Fondacioni Lumbardhi” informata dhe dokumentacion në lidhje me angazhimin e z. Veton Nurkollari dhe A. Sh. në këtë fondacion. E njëjta duke vepruar sipas kërkesës së Agjencisë, ka dërguar përgjigjen me informata dhe dokumentacionin përkatës.

Gjithashtu, Agjencia përmes komunikimit zyrtar ka marrë nga Departamenti për OJQ në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), informatat dhe dokumentacionin në lidhje me OJQ “Fondacioni Lumbardhi”.

Kësisoj, Agjencia pasi ka administruar si prova (vetëm provat që lidhen me vërtetimin e fakteve - pretendimeve për konflikt të interesit) kërkesën e raportuesit të rastit dhe dokumentacionin e bashkangjitur, deklaratën sqaruese të z. Veton Nurkollari dhe dëshminë e dorëzuar në Agjenci, përgjigjen dhe dokumentacionin e dërguar nga QKK, përgjigjen dhe dokumentacionin e dërguar nga përfaqësuesja e autorizuar e OJQ-së, si dhe informatat dhe dokumentacionin e pranuar nga Departamenti për OJQ në MPB, ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Referuar Statutit, Aktit themelues dhe informatave publike në dispozicion¹, OJQ “Fondacioni Lumbardhi” është themeluar në vitin 2015, si fondacion jofitimprurës.

Referuar dokumentacionit si më lartë dhe përgjigjes së përfaqësueses së autorizuar të OJQ-së në fjalë, rezulton se z. Veton Nurkollari dhe A. Sh. kanë qenë dy (2) nga pesë (5) themeluesit e OJQ “Fondacionit Lumbardhi”.

Sipas përgjigjes së përfaqësueses së autorizuar të OJQ “Fondacionit Lumbardhi”, pas themelimit të kësaj OJQ-je, z. Veton Nurkollari ka shërbyer si anëtar bordi (rol mbikëqyrës

¹ <https://ojq.rks-gov.net/KerkoOJQ.aspx>

dhe mbështetës, pa kompensim material) deri në nëntor 2023, ndërsa A. Sh. është emëruar drejtor ekzekutiv, pozitë të cilën vazhdon ta mbaje sot.

Fakti që z. Veton Nurkollari ka përfunduar shërbimin në bordin e drejtorëve të OJQ "Fondacioni Lumbardhi" në muajin nëntor të vitit 2023, për shkak të përfundimit të mandatit, vërtetohet edhe nga Raporti (procesverbali) i mbledhjes së XVIII-të të bordit të drejtorëve të këtij fondacioni, e mbajtur më datë 30.09.2023.

Sipas nenit neni 19 [Format e organizimit të OJQ-së], të Ligjit nr. 06/L- 043 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare, është përcaktuar se: "1. OJQ mund të organizohet si: 1.1. shoqatë; 1.2. fondacion; 1.3. institut."

... lidhur me nenin 16 [Shoqata], paragrafi 1 të këtij ligji, me të cilin është përkufizuar se: "Shoqata është **organizatë e anëtarësisë**, e grupuar në bazë të vullnetit të lirë të **personave me interes të përbashkët**, për realizimin e qëllimeve të ligjshme për përfitim publik ose për interes të ndërsjellë." Ndërsa me nenin 17 [Fondacioni], paragrafi 1, është përkufizuar se: "Fondacioni është organizatë **pa anëtarësi**, i themeluar për menaxhimin e pronave dhe pasurive, për realizimin e qëllimeve të ligjshme për përfitim publik ose për interes të ndërsjellë."

Rrjedhimisht, OJQ "Fondacioni Lumbardhi" e themeluar si fondacion jofitimprurës, nuk është organizatë (shoqatë) e anëtarësisë së saj, por është organizatë (fondacion) pa anëtarësi.

Më datë 20.12.2023, QKK ka shpallë Konkurs për film të metrazhit të gjatë – artistik (mbi 60 minuta), Ref. Nr. QKK 01/2023, i cili ka qenë i hapur për aplikim nga data 20.12.2023 deri më 24.01.2024, përkatësisht deri më 16.02.2024 (shtyrje e afatit).

Sipas Vendimit QKK. Nr. 12/2024, i datës 04.03.2024, të Drejtoreshës së QKK-së, i ndryshuar/plotësuar me Vendimin QKK. Nr. 34/2024, i datës 15.04.2024, z. Veton Nurkollari është emëruar anëtar i jurisë vlerësuese për vlerësimin e projekteve filmike të konkursit si më lartë, për kategoritë film i metrazhit të gjatë artistik, film i metrazhit të gjatë debutues dhe bashkëprodhim minoritar për film të metrazhit të gjatë artistik, dokumentar e të animuar.

Referuar listës së projekteve të përzgjedhura të publikuar nga QKK, si dhe shkresës së QKK-së për projektet fituese në kategorinë për film të metrazhit të gjatë, rezulton se njëri nga dy (2) projektet e përzgjedhura në këtë kategori është edhe projekti "Z." i shtëpisë filmike "V. F.", producent i të cilit projekt ka qenë A. Sh.

Në bazë të procesverbaleve të mbledhjeve të jurisë vlerësuese për projektet e kategorisë si më lartë, dhe në bazë të vlerësimeve individuale të anëtarëve të kësaj jurie për secilin projekt, është vërtetuar se z. Veton Nurkollari në cilësi të anëtarit të jurisë vlerësuese, ka marrë pjesë në mbledhjet e kësaj jurie dhe në vlerësimin e projekteve, përveç tjerave edhe projektit "Z.", të shtëpisë filmike "V. F.", producent i të cilit projekt ka qenë A. Sh.

Rrjedhimisht, shpallja e konkursit nga QKK, emërimi i z. Veton Nurkollari anëtar i jurisë vlerësuese, si dhe procesi i vlerësimit të aplikacioneve për film të metrazhit të gjatë, është bërë në kohën kur z. Veton Nurkollari nuk ka qenë anëtar i bordit drejtues të OJQ "Fondacioni Lumbardhi".

Në përgjigjen zyrtarë të QKK-së, ndër të tjera është theksuar se: “[...] Gjatë procesit të zbatimit të konkursit për subvencionim të filmave të metrazhit të gjatë artistik, nuk kemi pranuar asnjë kërkesë prej aplikantëve për përjashtim nga procedura të anëtareve të jurive apo komisioneve. Të gjithë anëtarët e jurisë kanë bërë deklaram nën betim se nuk kanë konflikt interesi me aplikantët e konkursit. Gjithashtu nuk kemi marrë asnjë sinjalizim as nga aplikantët e as nga asnjë person i jashtëm se mund të ketë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikantëve dhe jurive [...]”.

Për më tepër, referuar deklaratës nën betim të cilën z. Veton Nurkollari e ka nënshkruar më datë 15.03.2024, ndër të tjera ka theksuar se: “[...] deklaroj se nuk kam konflikt të interesit me asnjërin nga konkurrentët e projekteve që kanë aplikuar në konkursin e QKK-së, ku unë jam emëruar anëtar i jurisë vlerësuese”.

Andaj, në vështrim të pretendimeve dhe gjendjes faktike të konstatuar si më lartë, Agjencia vendosi si në pikën I. të dispozitivit të këtij vendimi, se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit, duke u bazuar në dispozitat e nenit 6 dhe nenin 17 lidhur me nenin 3 të LPKI-së.

Së këndejmi, konflikti i interesit është i lidhur ngusht me *vendimmarrjen* e zyrtarit në një çështje të caktuar, në të cilën zyrtari ka apo mund të ketë *interes* privat për vete apo për *personat e afërm* me të.

Kështu, me nenin 6 të LPKI-së është përkufizuar nocioni i konfliktit të interesit, ashtu që: “Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka *interes privat*, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtarë”, ndërsa me dispozitën e nenit 17 [Deklarimi rast për rast i interesave private të zyrtarit], paragrafi 1 të LPKI-së është përcaktuar se: “Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat ose **të personave të afërm** me të lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiqet nga kjo vendimmarrje.”

... lidhur me nenin 3 [Përkufizimet] paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të LPKI-së, me të cilin është përkufizuar se: “*interesi privat i personit zyrtar* - nënkupton çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, **të afërmit**, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste”, dhe nënparagrafi 1.6, me të cilin është përkufizuar se: “**Person i afërm me zyrtarin** është – bashkëshorti ose personi që bashkëjeton, të afërmit në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, adoptuesi, i adoptuari, i afërmi në gjini të krushqisë deri në shkallën e dytë si dhe çdo person fizik apo juridik i cili ka pasur ose ka një lidhje të përbashkët interesi privat pasuror ose jopasuror me zyrtarin. Për qëllime të këtij ligji, personi juridik konsiderohet si person i afërm, sipas dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.”

Në rastin konkret, në kuptim dhe zbatim të dispozitave si më lartë, është fakt se z. Veton Nurkollari në cilësi të anëtarit të jurisë vlerësuese ka qenë pjesë e procesit (vendimmarrës) të vlerësimit dhe përzgjedhjes së projekteve aplikuese për film të metrazhit të gjatë, ku në mesin e filmave të përzgjedhur në këtë kategori ka qenë edhe projekti “Z.” i shtëpisë filmike “V. F.”,

producent i të cilit projekt ka qenë A. Sh., por producenti A. Sh. nuk konsiderohet person i afërm i z. Veton Nurkollari.

Kjo ngase, vet fakti se z. Veton Nurkollari ka qenë (deri në muajin nëntor 2023) anëtar i bordit të drejtorëve të OJQ “Fondacioni Lumbardhi”, ndërkohë që A. Sh. është drejtor ekzekutiv i fondacionit në fjalë, si dhe fakti që të njëjtit figurojnë si themelues të të këtij fondacioni në vitin 2015, *apriori* nuk nënkupton se A. Sh. është person i afërm i z. Veton Nurkollari.

Kësisoj, pjesmarrja e zyrtarit në *vendimmarrje* dhe ekzistimi i interesit privat apo *interesit të personave të afërm* të zyrtarit në atë *vendimmarrje*, janë kushte *kumulative* të cilat duhet të plotësohen në çdo rast për t’u konsideruar se ka konflikt të interesit në *vendimmarrje*, sipas dispozitave të nenit 6 dhe nenit 17 të LPKI-së. Në këtë rast, siç është konstatuar më lartë, z. Veton Nurkollari ka marrë pjesë në *vendimmarrje* me rastin e vlerësimit të aplikacionit për një projekt në të cilin producent ka qenë A. Sh., por që në këtë rast nuk është plotësuar *kushti* tjetër kumulativ, që është *interesi i personave të afërm të zyrtarit*.

II. Agjencia vendosi si në pikën II. të dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në nenin 22 [Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit], paragrafi 12 të LPKI-së, me të cilin është përcaktuar se: “*Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimtarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.*”, si dhe paragrafin 15 të këtij neni, me të cilin është përcaktuar se: “*Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative.*”

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.


Ylli Buleshkaj
Drejtore i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit

Vendimi iu dërgohet:

- z. Veton Nurkollari;
- Raportuesit të rastit;
- Drejtorit të DPKI-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

